



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Himarë, më 30.09.2024

Nr. 69 prot.

**PROCESVERBAL I KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË ZBARDHUR NGA  
ORGJINALI MBAJTUR NË MBLEDHJEN E RADHE TE DATËS 30.09.2024**

Sot më datë 30.09.2024, ora 10:00 zhvillohet mbledhja e radhës e këshillit Bashkiak Himarë. Mbledhje e hapur.

Me rend dite : Betimi i kryetarit të Bashkisë Himarë, dal nga zgjedhjet vendore më datë 04.08.2024

Të ftuar Prefekti Qarkut Vlorë, Kryetari Këshillit Vlorë, Përfaqësues nga ministria vendore, përfaqësues nga ministria e jashtme, kryetarët e bashkive për qarkun Vlorë, deputet të Qarkut, përfaqësues nga besimi fetar, drejtuesi politik i qarkut Vlorë, sekretar I përgjithshëm i partisë socialiste, administrator të njësive bashkia Himarë, kryetarët e fshatrave.

Marrin pjesë këshilltarët: 1. Aleks Llazari, 2. Timoleo Gërdhuqi, 3. Dhimitër Kapaj, 4. Elisabeta Lamaj, 5. Milto Nika,

6. Artan Bala, 7. Gjergji Iliadhi, 8. Thodhori Foto, 9. Artionil Shirokaj, 10. Fuat Mati, 11. Loreta Isufi, 12. Nertila Husi, 13. Maks Vlasi, 14. Qirjako Mërkuri, 15. Mirka Gjçali, 16. Nikolin Laska

Mungojnë : 1. Afroviata Dhimojani, 2. Silva Burbo, 3. Thëllëza Kokaveshi, 4. Miltiadh Prifti, 5. Lenica Kocani

Plotësohet Kuorumi këshilltarëve

Mbledhjen e hap Kryetari Këshillit Z. Dhimitër Kapaj me fjalimin përshëndetës.

I nderuar Prefekt i Qarkut Vlorë,

I nderuar Kryetar i Qarkut Vlorë,

I nderuar Sekretar i përgjithshëm i Partisë Socialiste.

I nderuar drejtues politikë qarku Vlorë,

Të nderuar këshilltarë.

Të nderuar përfaqësues të partive politike !

Të nderuar përfaqësues të besimit fetar!

Të nderuar përfaqësues të mediave !

Ju uroj mirëseardhjen!

Kam nderin dhe përgjegjësinë institucionale të hap mbledhjen e sotme, e cila konsiston në betimin e Kryetarit të Bashkisë Himarë, fitues ne zgjedhjet e datës 4 gusht 2024.

Falenderoj të gjithë votuesit e Bashkisë Himarë e në veçanti falenderoj të gjithë ata votues që drejtimin e Bashkisë Himarë ja besuan Z. Vangjel Tavo. Ne besojmë fort se Kryetari që votuam do të mbajë të gjitha premtimet e bera ndaj komunitetit gjatë fushatës elektorale. Ne të gjithë e dimë se Bashkia Himarë ka kaluar sfida të vështira për shkak të situatave të ndodhura, menaxhimi i të cilave nuk ka qënë e lehtë për ne. Dua të falenderoj kryetarët e mëparshëm të Bashkisë për gjithë bashkëpunimin e tyre. Njëkohësisht qeverinë për projektet, investimet, bashkëpunim dhe vëmendjen e vecantë për Bashkinë Himarë.

Dua të falenderoj të gjithë anëtarët e këshillit Bashkiak pasi sëbashku kemi shqyrtuar projekte dhe kemi ndërmarrë vendime në shërbim të qytetarëve, dhe për zhvillimin e më tejshëm të Bashkisë Himarë edhe pse situatat kanë qënë të vështira. Gjatë këtyre muajve të ngarkuar kemi punuar përtej idealeve politike, duke patur prioritet të dëgjojmë zërin e qytetarëve dhe banorëve të Himarës. Falenderoj Z. Tavo për përkushtimin e deritanishëm dhe gjithë mbështetjen e tij ndaj Bashkisë Himarë. Jam i bindur dhe besim plotë se me Vangjelin do të zbatojmë të gjitha vendimet e marra, si dhe do të bashkëpunojmë për projekte me impakt për të ardhmen duke ruajtur edhe bashkëpunimin me trazhgimin e kulturës fetare , pasi feja është faktor paqeje në shoqëri.

Le të jetë mbledhja sot, e në vazhdimësi shembull i qytetarisë, frymës, bashkëpunuese dhe ideve zhvillimore, me qëllim rritjen e standardeve të shërbimeve të ofruara, rritjen e qytetarëve të shërbyer e të kënaqur, rritjen e numrit të turistëve, rritjen e të ardhurave, rritjen e projekteve dhe investimeve.

Himara është e para!

Vazhdojmë me rendin e ditës kryetari këshillit fton t'i bashkohet këshillit kryetari i ri i Bashkisë ,ndërkohë lexon formulën e betimit për kryetarin e bashkisë . Z.Tavo:- **BETOHEM!**

Ndërkohë firmos formulën e betimit. Kryetari i këshillit i vendos shiritin që është edhe simbol i çdo kryetari bashkie dhe ndërkohë shtrëngojnë duhet duke i uruar suksese,duartrokitje nga këshilli dhe të ftuarit në sallë.

Kryetari i ri i sapo betuar mban fjalimin përshëndetës!

**Të nderuar banorë të Himarës,**

Jam tejet i privilegjuar të nis sot zyrtarisht punën në detyrën e Kryetarit të Bashkisë së Himarës.

Ndihem shumë i nderuar që do i shërbej Himarës dhe të gjithë banorëve në çdo njësi, zonë e fshat nën administrimin e kësaj bashkie.

Kryebashkiaku njihet ndryshe edhe si qytetari i parë, por unë ju zotohem se nuk do jem qytetari i parë, por shërbëtori i parë i Himarës, pasi unë do drejtoj duke shërbyer. Do punoj me të gjitha aftësitë dhe energjitë e mia, në të mirë të çdo banori, për përmirësimin e jetës së komunitetit dhe zhvillimin afatgjatë e të qëndrueshëm të Himarës.

Unë besoj se rrethanat e jetës dhe providenca kohore na vendosin në një pozicion shoqëror për një arsye të caktuar. Kjo arsye është misioni dhe përgjegjësia për të shërbyer, për të kryer detyrën funksionale me integritetin më të lartë njerëzor, për të transformuar komunitetin, dhe për të lënë gjurmë në jetën e njerëzve dhe familjeve të thjeshta.

Unë do drejtoj duke i shërbyer çdo banori, pa dallim bindjesh politike, statusi shoqëror apo përkatësie zone e krahine. Kjo bashki nuk do ketë ngjyrë partiake sepse Himara është një dhe e pandarë.

Bashkia e Himarës nuk do jetë preferenciale por gjithëpërfshirëse, nuk do jetë një godinë burokratike por një qendër komunitare me zemër e me mendje, që përkujdeset thellësisht për nevojat jetike të banorëve e që ideon plane zhvillimore që do konsolidojnë Himarën e së ardhmes, ashtu siç e meriton, kartolinë e jugut dhe e rivierës së vendit, destinacioni më mikpritës, më tërheqës e më i mrekullueshëm i vizitorëve vendas e të huaj.

Por mbi të gjitha një zonë e jetueshme për banorët lokalë, me standarde dhe zhvillim, me shërbime funksionale dhe ekonomi më të mirë, jo vetëm për Himarën në tërësi por edhe për atë familjare. Që çdo banor, çdo familje, çdo komunitet të jetojë më mirë, e të ketë një jetesë më dinjitoze e një të ardhme më të sigurtë.

Bashkia e Himarës do jetë bashkia juaj. Dyert e bashkisë dhe dera e zyrës sime do jenë gjithmonë të hapura për banorët e thjeshtë, për shqetësimet dhe nevojat e komunitetit. Do jenë të hapura edhe për ide dhe angazhim nga cilido individ apo institucion që kërkon të kontribuojë në të mirën e Himarës.

Himarjotët që jetojnë jashtë vendit, intelektualët, profesionistët, por edhe institucionet vendase dhe të BE-së, përfaqësitë e huaja, organizatat jofitimprurëse, e të tjera, janë të mirëpritura të vijnë e të japin ndikimin e tyre në të mirë të Himarës.

Dyert janë të hapura për këdo e gjithçka që i shërben Himarës, por do jenë e do mbeten gjithmonë të mbyllura ndaj paligjshmërisë, abuzimit dhe korrupsionit sepse himarjotët

meritojnë një bashki që punon për ta, e jo që përfiton prej tyre, që i shërben Himarës dhe jo interesave të ngushta personale.

Himarjotët meritojnë një bashki që u ofron zgjidhje, që administron profesionalisht të mirën e përbashkët, dhe jo që u shkakton probleme e ua vështirëson jetesën. Himarjotët meritojnë një institucion të cilin ata mund të gjejnë mbështetje në çdo kohë e për çdo çështje. Ndaj unë e ftoj Këshillin Bashkiak, e çdo anëtar të kështillit, pa dallim politik, të punojmë së bashku, me një qasje ndërtuese dhe shërbimi ndaj Himarës, duke i shndërruar mbledhjet dhe takimet tona si një forum ideshë e jo derivate të prapavijës politike. Me dëshirën, vullnetin dhe integritetin për të marrë vendime që i shërbejnë Himarës, sepse e mira e Himarës kapërcen çdo bindje, interes e përfitim personal.

Sepse e mira e Himarës është e mira e së ardhmes, e fëmijëve që rriten këtu e duan ta ndërtojnë jetën e tyre këtu, në këtë zonë kaq të bekuar, që me angazhimin dhe me punën tonë të përbashkët mund të transformohet në vendin e mundësive të pafundme.

Kjo bashki do jetë transparente në administrimin dhe përdorimin e fondeve publike sikurse edhe mikpritëse për çdo lloj bashkëpunimi me sektorin jo-publik që i shërben zhvillimit të Himarës dhe përmirësimit të standardit të jetesës së banorëve.

Kjo bashki nuk do jetë kurrësesi një institucion burokratik pasiv, por një aktor e faktor i rëndësishëm aktiv në realizimin e nismave dhe projekteve të reja, e që do trokasë në dyert e pushtetit qendror e do hapë porta të reja bashkëpunimi me instancat e BE-së dhe partnerë të tjerë Euro-Atlantik.

Të nderuar miq,

Sfidat janë të shumta. Problematikat janë nga më të ndryshmet, në të gjitha sektorët e jetës komunitare, por nga përvoja ime e gjatë politike dhe administrative, kam mësuar se kur ka vullnet e dëshirë çdo gjë mund të realizohet.

Nuk jemi mrekulli-bërës, por jemi të aftë, të gatshëm e të vullnetshëm. E këto janë shtypa të mjaftueshme për të sjellë ndryshimin dhe transformimin.

Duke shtuar edhe mbështetjen e plotë të qeverisë shqiptare, të vetë Kryeministrit Rama, të cilin e falenderoj jo vetëm për besimin që pati te unë për të kandiduar për kryetar të bashkisë së Himarës, por për vizionin dhe mbështetjen e madhe që ka treguar si para zgjedhieve, ashtu

dhe himarjotëve t' u sigurohet ajo që ata meritojnë: një jetë më të mirë, një qytet më të jetueshëm, një Himarë, me të gjitha njësitë administrative të saj, më të zhvilluar dhe më optimiste për të ardhmen.

Shpreh mirënjohjen time të thellë për të gjithë ata që kontribuan me mbështetjen e tyre që unë të jem sot përpara jush si Kryetar i Bashkisë së Himarës.

Falenderoj familjen time, miqtë, dashamirësit, stafin tim elektoral dhe strukturat e Partisë Socialiste, të gjithë ata që besuan te unë dhe mbi të gjithë banorët e bashkisë së Himarës që më zgjodhën t' u shërbej në këtë detyrë në këtë detyrë fisnike.

Kjo përgjegjësi e shumëfishtë më nxiti ta përmbush besimin e dhënë me devotshmërinë dhe integritetin më të lartë njerëzor dhe institucional. Duke dhënë më të mirën time në funksionimin sa më profesional të kësaj detyre që më është ngarkuar.

Një detyrë që nuk kryhet i vetëm por së bashku, sepse vetëm së bashku do i shërbejmë më shumë Himarës. Vetëm së bashku do forcojmë harmoninë dhe bashkëjetesën, e do sigurojmë mirëqenien për komunitetin dhe familjet e thjeshta.

Në mbyllje, dua të theksoj se, zbatimi i ligjit, transparenca, bashkëpunimi, përgjegjshmëria, gjithëpërfshirja dhe shërbimi do jenë parime të panegociueshme për mua.

Por, gjithashtu, udhërrëfyes në punën time të përditshme do të jenë të gjithë ato banorë që kam takuar - të gjitha ato duar që kam shtrënguar - të gjithë ato zëra që kam dëgjuar - e të gjitha ato familje të thjeshta që kanë ndarë me mua shqetësimet e tyre dhe nevojat që kanë ata dhe i gjithë komuniteti.

Ndaj misioni im është e do të jetë: Në shërbim të banorëve - Në shërbim të Himarës - Në shërbim të një të ardhmeje më të mirë për të gjithë ne dhe fëmijët tanë.

Me respekt,

Vangjel Tavo ! Mbas fjalimit kryetari këshillit e deklaroi mbledhjen të mbyllur pasi nuk ka materiale të tjera për të shqyrtuar.

Mirë u takofshim në mbledhjen e radhës!

Sekretari  
Elena Memushaj  
Gllus